

VENDIM
Nr. 366, datë 29.5.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR REDUKTIMIN E ÇMIMIT TË SHËRBIMEVE *ROAMING* NË RRJETET PUBLIKE TË KOMUNIKIMIT CELULAR NË RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për reduktimin e çmimit të shërbimeve *roaming* në rrjetet publike të komunikimit celular në rajonin e Ballkanit Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE

MBI REDUKTIMIN E ÇMIMIT TË SHËRBIMEVE *ROAMING* NË RRJETET PUBLIKE TË KOMUNIKIMIT CELULAR NË RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

Përfaqësuesit e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor që nënshkruan Deklaratën për Mbështetje të Agjendës Dixhitale për Ballkanin Perëndimor në Sofje në datën 17 maj 2018 (në vijim të referuar kolektivisht si “Nënshkruesit” dhe individualisht si “Nënshkrues”),

duke njohur rëndësinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike për prosperitet social dhe ekonomik;

duke vazhduar zhvillimin e bashkëpunimit për çështjet që lidhen me reduktimin e çmimeve të shërbimeve *roaming* në rajonin e Ballkanit Perëndimor, bazuar në konceptin e barazisë dhe përfitimit reciprok;

duke ndjekur procesin për të arritur një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, konkurrencës dhe transparencës në tregun e komunikimeve elektronike;

duke marrë parasysh:

- Që çmimet e shërbimeve *roaming* në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbeten të larta, që çmimet e shitjes me pakicë të shërbimeve *roaming* në Bashkimin Evropian janë të njëjta me çmimet vendase, p.sh. “*roaming like at home*” në bazë të rregulloreve të mëposhtme:

- Rregullores (BE) nr. 531/2012 mbi *roaming*-un në rrjetet publike të komunikimeve celulare brenda Bashkimit, e ndryshuar nga Rregullorja (BE) 2015/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 nëntor 2015 dhe Rregullorja (BE) 2017/920 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 maj 2017;

- Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2016/2286 të datës 15 dhjetor 2016, e cila përcakton rregullat e hollësishme mbi zbatimin e politikës së përdorimit të drejtë dhe mbi metodologjinë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së heqjes së çmimeve shtesë të shitjes me pakicë të *roaming*-ut dhe mbi kërkesën që duhet të dorëzohet nga një ofrues i shërbimeve *roaming* për qëllime të këtij vlerësimi; dhe

- Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/1979, të datës 13 dhjetor 2018, e cila përcakton mesataren e ponderuar të tarifave maksimale të terminimit të shërbimeve të lëvizshme në të gjithë Bashkimin;

- Përfitimet e uljes së kostove të *roaming*-ut për një mbulim të plotë të përdoruesve fundorë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, të miratuar në Deklaratën për Mbështetje të Axhendës Digjitale për Ballkanin Perëndimor;

- Objektivin e integritimit ekonomik rajonal dhe angazhimet e ndërmarra në Planin Shumëvjeçar të Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale (MAP REA);

Nënshkruajnë këtë Marrëveshje për reduktimin e çmimit të shërbimeve *roaming* në rrjetet publike të komunikimeve celulare në rajonin e Ballkanit Perëndimor (në vijim e referuar si “Marrëveshja”).

Termat e përdorur në këtë Marrëveshje duhet të kenë të njëjtin kuptim me ato të përdorura në rregulloret e mësipërme, të cilat zbatohen brenda Bashkimit Evropian, duke pasur parasysh mbulimin specifik territorial të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1

Nënshkruesit bien dakord që është i nevojshëm një reduktim i mëtejshëm i çmimeve të shërbimeve *roaming* për një mbulim të plotë të të gjithë përdoruesve fundorë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Nënshkruesit bien dakord që tarifat maksimale të shitjes me pakicë të shërbimeve *roaming* në rajonin e Ballkanit Perëndimor duhet të sillen në nivelin e çmimit sipas rregullit “si në vendin e tyre”, d.m.th. që i korrespondojnë rregullave të “mospagimit të tarifave shtesë të *roaming*-ut gjatë qëndrimit jashtë vendit”, të zbatueshme në Bashkimin Evropian, jo më vonë se data 1 korrik 2021. Nënshkruesit bien dakord që do të ndërmarrin hapat e nevojshme përgatitore brenda kësaj date.

Nënshkruesit bien dakord të zbatojnë një regjim kalimtar për shërbimet *roaming*, duke filluar nga data 1 korrik 2019.

Neni 2

Nga data 1 korrik 2019 deri më 30 qershor 2021, ofruesit e shërbimeve *roaming* në rajonin e Ballkanit Perëndimor mund të aplikojnë një çmim shtesë përveç çmimit vendas të shitjes me pakicë për ofrimin e shërbimeve të rregulluara *roaming* me pakicë. Për thirrjet e rregulluara *roaming* nuk do të aplikohet tarifë për vendosjen/konfigurimin e thirrjes. Nëse tarifa për vendosjen e thirrjes aplikohet për tarifat vendase të shitjes me pakicë, kjo tarifë duhet të përjashtohet nga tarifat e shërbimeve të rregulluara *roaming* me pakicë, të llogaritura sipas këtij Neni.

Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në paragrafin 1, kur një ofrues i shërbimeve *roaming* në rajonin e Ballkanit Perëndimor aplikon një çmim shtesë për konsumimin e shërbimeve të rregulluara *roaming* me pakicë, ky i fundit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme (duke përjashtuar TVSH-në):

a) çdo çmim shtesë i aplikuar për thirrjet e rregulluara *roaming* të kryera, mesazhet SMS të rregulluara *roaming* të dërguara dhe shërbimet e rregulluara të të dhënave në regjimin *roaming* nuk duhet të kalojë përkatësisht 0,05 EURO për minutë, 0,02 EURO për SMS dhe 0,025 EURO për megabajt të përdorur; nga data 1 korrik 2020, çdo çmim shtesë i aplikuar për shërbimet e rregulluara të të dhënave *roaming* në regjimin *roaming* nuk duhet të kalojë 0,015 EURO për megabyte të përdorur;

b) shuma e çmimit vendas të shitjes me pakicë dhe çdo çmim shtesë i aplikuar për thirrjet e rregulluara *roaming* të kryera, mesazhet SMS të rregulluara *roaming* të dërguara ose shërbimet e rregulluara të të dhënave në regjimin *roaming* nuk duhet të kalojë përkatësisht 0,19 EURO për minutë, 0,06 EURO për SMS dhe 0,18 EURO për megabyte të përdorur. Në rast se çmimi vendas i shitjes me pakicë është më i lartë se çmimi maksimal i shitjes me pakicë të *roaming*-ut, do të zbatohet ky i fundit, edhe nëse nuk aplikohet çmim shtesë;

c) çdo çmim shtesë i aplikuar për thirrjet e rregulluara *roaming* të pranuar nuk duhet të kalojë

tarifat maksimale të terminimit prej 0,04 EURO për minutë nga data 1 korrik 2019, 0,025 EURO për minutë nga data 1 korrik 2020, 0,016 EURO për minutë nga data 1 korrik 2021 e në vazhdim.

Ofruesit e shërbimeve *roaming* nuk do të aplikojnë ndonjë çmim shtesë për mesazhe SMS të rregulluara *roaming* të marra ose për mesazhe zanore *roaming* të marra. Kjo do të aplikohet pa cenuar tarifat e tjera të zbatueshme, të tilla si ato për dëgjimin e këtyre mesazheve zanore.

Neni 3

Nga data 1 korrik 2019, operatorët e rrjeteve celulare në rajonin e Ballkanit Perëndimor duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e arsyeshme për aksesin në shitjet me shumicë të shërbimeve *roaming*, për ofruesit e këtyre shërbimeve, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Nga data 1 korrik 2019 deri më 30 qershor 2021, çmimi mesatar maksimal me shumicë i *roamingut* që operatori i rrjetit të vizituar mund të kërkojë nga ofruesi i *roamingut* për ofrimin e një prej shërbimeve të rregulluara *roaming* me origjinë nga rrjeti i vizituar, duke përfshirë koston e origjinës, tranzitit dhe terminimit, nuk duhet të tejkalojë 0,05 EURO për minutë për thirrjet e rregulluara *roaming*, 0,02 EURO për mesazhet SMS të rregulluara *roaming* dhe 0,025 EURO për megabyte të të dhënave të transmetuara në regjimin *roaming*. Nga data 1 korrik 2020, çmimi mesatar maksimal me shumicë i *roamingut* për shërbimet e rregulluara të të dhënave në regjimin *roaming* nuk duhet të kalojë 0,015 EURO për megabyte të të dhënave të transmetuara.

Nga data 1 korrik 2021, çmimi mesatar maksimal me shumicë i *roamingut* që operatori i rrjetit të vizituar mund të kërkojë nga ofruesi i *roamingut* për ofrimin e një prej shërbimeve të rregulluara *roaming* me origjinë nga rrjeti i vizituar, duke përfshirë koston e origjinës, tranzitit dhe terminimit, nuk duhet të tejkalojë 0,032 EURO për minutë për thirrjet e rregulluara *roaming*, 0,01 EURO për mesazhet SMS të rregulluara *roaming* dhe 0,0077 EURO për megabyte të të dhënave të transmetuara në regjimin *roaming*. Çmimi mesatar maksimal me shumicë i *roamingut* për shërbimet e rregulluara të të dhënave *roaming* do të ulet në 0,006 EURO për megabajt në datën 1 janar 2022, në 0,0045 EURO për megabajt më 1 janar 2023, në 0,0035 EURO për megabajt më 1 janar 2024, në 0,003 EURO për megabajt më 1 janar 2025 dhe në 0,0025 EURO për megabajt nga data 1 janar 2026 e në vazhdim.

Neni 4

Autoritetet rregullatore për komunikimet elektronike në rajonin e Ballkanit Perëndimor (në vijim të referuar si “Rregullatorët”) do të jenë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes, duke përfshirë rregullimin e tarifave të terminimit të telefonisë të lëvizhme për thirrjet e rregulluara *roaming* me origjinë dhe me destinacion në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, bazuar në reciprocitetin e tarifave, në përputhje me qëndrueshmërisë e detyrimeve të përcaktuara në Nenin 2, paragrafi 2, pikat “a” dhe “c”, jo më vonë se data 1 korrik 2019.

Tarifat maksimale të terminimit të thirrjeve të rregulluara *roaming* me origjinë dhe destinacion drejt rajonit të Ballkanit Perëndimor nuk duhet të tejkalojnë: 0,04 EURO për minutë nga data 1 korrik 2019, 0,025 EURO për minutë nga data 1 korrik 2020, 0,016 EURO për minutë nga data 1 korrik 2021 e në vazhdim.

Neni 5

Duke filluar nga data 1 korrik 2021, ofruesit e shërbimeve *roaming* në rajonin Ballkanin Perëndimor nuk mund të aplikojnë asnjë shtesë përveç çmimit vendas të shitjes me pakicë për konsumatorët e *roamingut* në rajonin e Ballkanit Perëndimor për asnjë nga thirrjet *roaming* të rregulluara, të marra apo të kryera, për asnjë nga mesazhet SMS *roaming* të rregulluara të dërguara dhe për asnjë nga të dhënat *roaming* të rregulluara të përdorura, duke përfshirë edhe mesazhet

MMS, si dhe asnjë pagesë tjetër për të mundësuar përdorimin jashtë vendit të pajisjes fundore ose të shërbimit.

Ofruesit e shërbimeve *roaming* mund të zbatojnë “politikën e përdorimit të drejtë” për konsumimin e shërbimeve të rregulluara *roaming* me pakicë, të cilat ofrohen me nivelin vendas të çmimit të shitjes me pakicë, me qëllim që të parandalojnë një përdorim abuziv ose anormal të shërbimeve të rregulluara *roaming* me pakicë nga ana e konsumatorëve të këtyre shërbimeve, të tilla si përdorimi i tyre në një vend Nënshkrues të ndryshëm nga ai i ofruesit vendas, për qëllime të ndryshme nga ato të udhëtimeve periodike.

Çdo politikë e përdorimit të drejtë duhet t’u mundësojë konsumatorëve të shërbimeve *roaming* të konsumojnë vëllimet e shërbimeve të rregulluara *roaming* me pakicë me çmimin vendas të shitjes me pakicë, në fuqi, në përputhje me planet tarifore përkatëse dhe me rregullat e përcaktuara nga secili Nënshkrues.

Në rrethana specifike dhe të jashtëzakonshme, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së modeleve vendase të tarifimit, kur një ofrues i shërbimit *roaming* nuk mund të mbulojë koston totale aktuale ose të planifikuar për ofrimin e shërbimeve të rregulluara *roaming* nga të ardhurat totale aktuale ose të planifikuara për ofrimin e këtyre shërbimeve, ky mund të aplikojë tek autoriteti kombëtar rregullator për autorizim që të aplikojë një çmim shtesë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga secili Nënshkrues. Ky çmim shtesë do të aplikohet deri në masën e nevojshme për të mbuluar kostot për ofrimin e shërbimeve të rregulluara *roaming* me pakicë, duke marrë parasysh tarifat maksimale të zbatueshme të shitjes me shumicë.

Çdo çmim shtesë i aplikuar për shërbimet e rregulluara *roaming* me pakicë në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk duhet të kalojë tarifat maksimale me shumicë, në përputhje me nenin 3, paragrafi 4 dhe për thirrjet *roaming* të pranuar, me tarifat maksimale të terminimit celular në përputhje me nenin 2, paragrafi 2, pika “c”.

Çmimi maksimal i përmendur në nenin 2, paragrafi 2, pika “b” do të aplikohet për çdo shërbim të rregulluar *roaming* me pakicë që u ofrohet konsumatorëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Neni 6

Nënshkruesit, deri në datën 1 korrik 2019, duhet të miratojnë çdo ndryshim në ligjet dhe/ose aktet nënligjore të komunikimeve elektronike, të nevojshëm për arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë edhe harmonizimin e nivelit të politikës së mbrojtjes së konsumatorit me standardet që mbizotërojnë brenda BE-së.

Ndryshimet në ligjet dhe/ose aktet nënligjore, të nevojshme për të garantuar që zbatimi i rregullave mbi politikën e përdorimit të drejtë, rregullave mbi zbatimin e një mekanizmi derogimi të qëndrueshëm dhe kërkesave të transparencës që i korrespondojnë të njëjta rregullave të zbatueshme në Bashkimin Evropian, të jetë uniform tek të gjithë Nënshkruesit dhe duhet të miratohet nga Nënshkruesit jo më vonë se data 31 dhjetor 2020.

Neni 7

Zbatimi i Marrëveshjes do të koordinohet nga një organ i themeluar nga përfaqësuesit e Rregullatorëve.

Rregullatorët duhet të arrijnë koordinimin e nevojshëm në zbatimin e Marrëveshjes, në mënyrë që zbatimi i detyrimeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor të hyjë në fuqi në datën e përcaktuar në nenin 1, paragrafi 3.

Neni 8

Rregullatorët dhe operatorët e komunikimeve elektronike do të mbulojnë shpenzimet e

aktiviteteve të ndërmarra, me qëllim zbatimin e Marrëveshjes.

Neni 9

Rregullatorët do të shkëmbejnë në mënyrë të rregullt informacion mbi aktivitetet e ndërmarra, me qëllim zbatimin e Marrëveshjes.

Neni 10

Përfaqësuesit e Rregullatorëve duhet të takohen të paktën një herë në vit për tu konsultuar dhe për të shqyrtuar zbatimin e Marrëveshjes, për të identifikuar prioritetet për periudhën në vijim, me qëllim ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta, nëse çmohet e nevojshme, dhe të miratojnë qëndrime të përbashkëta ndaj organizatave vendase dhe evropiane përgjegjëse për komunikimet elektronike dhe ndaj operatorëve të komunikimeve elektronike.

Neni 11

Çdo Nënshkrues mund të tërhiqet nga Marrëveshja gjashtë muaj pas dërgimit të njoftimit tek Nënshkruesit e tjerë.

Marrëveshja mund të jetë objekt rishikimi, nëse rregullorja përkatëse e BE-së ndryshohet dhe/ose nëse është e nevojshme të harmonizohen më tej tarifat maksimale të terminimit dhe/ose çmimeve me shumicë për shërbimet e rregulluara *roaming*, me qëllim përmbushjen e objektivave të përcaktuara në nenin 1, paragrafi 2.

Neni 12

Kjo Marrëveshje zëvendëson “*Marrëveshjen mbi reduktimin e çmimeve të roaming në rrjetet publike të komunikimeve celulare ndërmjet ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike nga Bosnje dhe Hercegovina, Republika e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Republika e Serbisë*”, e nënshkruar më 29 shtator 2014, duke filluar nga data 1 korrik 2019.

Neni 13

Kjo Marrëveshje hartohet në gjashtë kopje në gjuhën angleze dhe çdo Nënshkrues mban një kopje.

Neni 14

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të aplikohet nga 1 korriku 2019.
Vendi dhe data e nënshkrimit: Beograd, 4 prill 2019

PËR BOSNJË DHE HERCEGOVINËN,
Saša Dalipagić, zëvendësministër

PËR KOSOVËN*
Valdrin Llluka, ministër

PËR MALIN E ZI,
Dragica Sekulić, ministër

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Dorina Cinari, zëvendësministër

PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË VERIORE,
Damjan Mančevski, ministër

PËR REPUBLIKËN E SERBISË
Rasim Ljajić, zëvendëskryeministër dhe ministër

* Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.